



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1777 /10 prot.

Datë 31.07.2026

V E N D I M
Nr. 915/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 789/2026 datë 11.06.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me REF-87831-05-28-2026, me objekt: “Loti 2: “Riparim dhe mirëmbajtje automjesh të Spitalit Sarandë” , me fond limit 6,970,033.33 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 08-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Alstezo” SHA , J63208420N dhe adresë: Zhupan Fier

Autoriteti: Operatori i Blerjeve të Përqendruara. me NIPT Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337(në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 11.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 789/2026 ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjeserisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” SHA, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me REF-87831-05-28-2026, me objekt: “Loti 2: “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh të Spitalit Sarandë”, me fond limit 6,970,033.33 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 08-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.*
 - 2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet dhe arsyetimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
 - 3. Autoriteti Kontraktor, brenda 5 diteve të verë ne dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
 - 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alstezo” SHA.*
 - 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 - 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr 2770/11 prot., datë 25.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1777/7 prot., datë 29.06.2026 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 789/2026, datë 11.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me REF-87831-05-28-2026, me objekt: “Loti 2: “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh të Spitalit Sarandë”, me fond limit 6,970,033.33 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 08-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

Me shkresën nr 2770/11 prot., datë 25.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1777/7 prot., datë 29.06.2026 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 789/2026, datë 11.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me REF-87831-05-28-2026, me objekt: “Loti 2: “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh të Spitalit Sarandë”, me fond limit 6,970,033.33 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 08-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Referuar informacionit të përcjellë nga autoriteti kontraktor, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojcën, në përputhje me vendimin Nr.789/2026, datë 11.06.2026 të këtij Komisioni.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për

miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me REF-87831-05-28-2026, me objekt: “Loti 2: “Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve të Spitalit Sarandë”, me fond limit 6,970,033.33 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 08-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Kryetar
Ismail Shehu

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Nertil Kanina

Anëtar
Edvin Simo